



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 30, datë 14.10.2020

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“STRUKTURË PËR GRUMBULLIMIN, THERJEN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E
KAFSHËVE, MALI I TOMORRIT, BASHKIA SKRAPAR”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Mali i Tomorrit” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Strukturë për grumbullimin, therjen, ruajtjen dhe përpunimin e kafshëve, Mali i Tomorrit, Bashkia Skrapar”, me zhvillues shoqërinë “Mali i Tomorrit” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Skrapar.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

MILVA EKONOMI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

